REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.br. 979/20
Datë/Datum 15/12/2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.979/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, i perbeser nga : z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P.SH – "Prishtina Auto L.L.C"- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizimin në DPQ" me nr. prok. KEK-20-1944-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues /AK/ "Korporata Energjetike e Kosovës",sh.a më datën: 14.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T.P.SH – "Prishtina Auto L.L.C" "- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizimin në DPQ" me nr. prok. KEK-20-1944-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK –KEK sh.a.

II. **VËRTETOHET**, njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit me titull "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizimin në DPQ" me nr. prok. KEK-20-1944-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues /AK/ "Korporata Energjetike e Kosovës",sh.a. dhe nëse shpreh interesim më tutje ta **Ri-tenderoj** atë.

III. Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta njoftoj KRPP-në lidhur me këto shkelje te AK-KEK.sh.a.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.T.P.SH – "Prishtina Auto L.L.C" "- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.P.SH – "Prishtina Auto L.L.C"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.11.2020 me nr. 979/20, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizimin në DPQ" me nr. prok. KEK-20-1944-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues /AK/ "Korporata Energjetike e Kosovës",sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 31 dhe 31.4 i RRUOPP-së, si dhe Vendimi i OSHP-se nr.884/14 pika 1 dhe 2.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr.1
Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka bere shkelje te nenit 7, 59 dhe 60 te LPP-se si dhe shkelje te nenit 31 te RRUOPP dhe vendimit te OSHP-se nr.884/14 sepse është anuluar aktiviteti i prokurimit edhe pse AK duhet të kërkojë me shkrim zgjatjen e validitetit të tenderit dhe atë duhet të kërkohet para datës së skadimit. AK nuk e ka respektuar këtë procedurë dhe si pasojë AK ka kërkuar nga OE Prishtina Auto LLC zgjatjen e validitetit të ofertë 18 ditë PAS datës së skadimit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Ky aktivitet i prokurimit nga AK është përcjellë me shume mangësi dhe devijim nga afatet e përcaktuara ne dosjen e tenderit lidhur me afatin e validitetin te ofertave dhe kërkesës se AK për zgjatjen e validitetit te ofertave. Po mundohem te jap një përshkrim te aktivitetit te prokurimit lidhur me këtë çështje te afateve ne

mënyrë qe ne përfundim te japim mendimin tone ne raport me dispozitat e LPP-se, legjislacionit sekondar dhe dispozitave te dosjes se tenderit..

Sipas nenit 22 faqe 7 te dosjes se tenderit, periudha e vlefshmërisë se tenderit shkruan:

22. Periudha e Vlefshmërisë se Tenderit	22.1 Tenderët do të mbeten të vlefshme për aq kohë sa është e **shënuar në FDT. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të filloj në datën e afatit të fundit te dorëzimit te tenderëve**. Një tender që është valid për një kohë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si jo e përgjegjshme. 22.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, **para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit**, autoriteti kontraktues **mund të kërkojë** nga tenderuesit **zgjatjen e periudhës** së vlefshmërisë së tenderëve të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. **Dështimi për t'iu përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit**, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.

Dorëzimi/hapja i tenderëve sipas platformës elektronike te KRPP-se është bere me datën **03.06.2020.**

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderëve

Shfaq të gjitha funksionet e dokument

Versioni i tanishëm: 03.06.2020 12:58 177 Proces verbali i hapjes se Tenderve.pdf

Shqip

Ne dosjen e tenderit, respektivisht te FDT-ja neni 22.1 i saje, shkruan qe vlefshmëria e tenderit është 60 dite.

Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: 60 ditë,

Pra nga hapja me date 03.06.2020 deri me datën 01.08.2020 oferta kane pasur validitet. Pra sipas nenit 22.2 te dosjes se tenderit te dhënë me larte "para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre".

Sipas dispozitës te cekur me larte, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit te ofertave para skadimit te tyre por këtë e ka bere me vonese, respektivisht me datën 19.08.2020, d.m th me 18 dite vonese. Me këtë rast AK nuk ka respektuar nenin 22 te dosjes se tenderit dhe nenin 31.4 te RRUOPP.

Arsyetimi i AK-së se vonesa e kërkesës për vazhdimin e validitetit është bere për shkak te gjendjes pandemike sepse zyrtari përkatës i AK-se i ngarkuar me këtë aktivitet te prokurimit ka qene i infektuar dhe ne izolim për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk është argument qe mundet te justifikohet.

Gabimi tjetër ne këtë proces i AK-se është se ne kërkesën për vazhdimin e validitetit te ofertës qe ka bere ne platformën elektronike me date 19.08.2020 ne ora 12:40 ka theksuar për ofertuesit se:

"ne presim përgjigje nga ana e juaj deri me datën 19.08.2020 ne ora 12".

Pra nga kjo shihet se është një **anomali apo gabim teknik i AK** ne përcaktimin e datës për kthimin e përgjigjes nga operatoret ekonomik ne te njëjtën date me njoftimin e AK-se te paraqitur ne sistemin e-prokurimi. Për këtë gabim te AK-së, nuk ka reaguar as OE ankues dhe nuk ka kërkuar sqarim prej AK-se, se deri ne cilën date mundet te behet vazhdimi i validitetit te ofertës ose edhe te përgjigjet ne kërkesën e AK-se, se pajtohet për vazhdim te validitetit te ofertës.

Mos përgjigja e Operatorit ekonomik ne kërkesën e AK-se për vazhdim te validitetit te ofertës sipas nenit 22.2 te dosjes se tenderit te dhënë me larte dhe nenit 31.6 te RRUOPP rezulton me refuzimin e **tenderuesit si i pa përgjegjshëm**. Mbi këtë baze ka vepruar edhe autoriteti kontraktues me ofertën e OE ankues sepse ky i fundit nuk ka kthyer përgjigje ne kërkesën e AK-se për vazhdimin e validitetit. Duhet theksuar se gjate kësaj faze, respektivisht prej datës 28.07.2020 deri me datën 04.09.2020 lënda ka qene e pezulluar dhe ne shqyrtim te një ankese paraprake nga OSHP. Me datën 04.09.2020 OSHP nxjerre vendimin nr.512/20 dhe kthen aktivitetin e prokurimit ne Rivlerësim.

Nga data 04.09.2020 e nxjerrjes se vendimit te OSHP-se nr.512/20 për rivlerësimin e këtij tenderi deri me datën

13.10.2020 respektivisht 15.10.2020 kur OE ankues ka kërkuar dy here sqarime prej AK-se për ecurinë e këtij aktiviteti te prokurimit, çështja ka mbetur e heshtur pa asnjë veprim nga AK.

Me datën 03.11.2020 autoriteti kontraktues ka ngarkuar ne platformën elektronike një raport te vlerësimit te ofertave i cili është mjafte i mangët dhe pjesërisht i plotësuar, pa ndonjë rekomandim te komisionit vlerësues. Me datën 10.11.2020 autoriteti kontraktues, përmes letrës standarde për eliminim njofton OE ankues se oferta e juaj është eliminuar për shkak se nuk jeni përgjigjur kërkesës tone për vazhdimin e validitetit te ofertës dhe sigurimit te tenderit. Ne te njëjtën datë jepet edhe Njoftimi mbi vendimin e AK-se për Anulim te aktivitetit te prokurimit për shkak se Operatorët Ekonomik nuk kanë vazhduar validitetin e ofertave. Marrë në përgjithësi sipas mendimit te ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues Autoriteti kontraktues gjate zhvillimit te këtij aktiviteti te prokurimit nuk ka respektuar ne tërësi dispozitat e nenit 59 te LPP-se, po ashtu nuk ka respektuar dispozitat e dosjes se tenderit dhe neni 31.4 i RRUOPP për vazhdimin e validitetit te ofertave. Aktiviteti i prokurimit është përcjellë me

lëshime te mëdha te mos respektimit te afateve kohore. Autoriteti kontraktues duhet te jete i kujdesshëm ne respektimin e afateve te përcaktuara me aktet juridike te fushës se prokurimit publik.
Nga data 01.08.2020 deri me tani kane kaluar 4 muaj qe kur ka skaduar validiteti i ofertave te tenderuesve pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit dhe te njëjtat nuk janë vazhduar.
Kërkesa e OE ankues për rivlerësim te këtij tenderi tani me oferta te skaduar qe katër muaj për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk ka mbështetje ligjore sipas LPP-së.
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht por kjo nuk do te ndikoj ne ndryshimin e vendimit te AK-se.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të mbaje ne fuçi vendimin për anulim për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizimin në DPQ" LOT 2 me nr. prok. KEK-20-1944-121 dhe nëse shpreh interesim më tutje ta Ri-tenderoj atë.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se konfirmojmë pranimin e raportit te ekspertit shqyrtues.nr.979/20.

Operatori Ekonomik, me datë: 07.12.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Deklarojm aë nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues pasiqe i njëjti ekspert pajtohet qe ka pas devijime nga AK dhe mos respektim i procedurave ligjore nga ana e AK-së, per ,me shum , AK nuk i ka përmbajtur aspak vendimit paraprak te OSHP-sëme numer 512/20 qe kërkohet qe lemda te rikthehet ne rivlerësim andaj nuk pajtohemi kësaj radhe me mendimin e ekspertit shqyrtues pasiqe i njëjti ekspert si ne rastin paraprak edhe ne kete rast, eshte i vetedijeshem qe AK vazhdimisht ka bere shkelje enorme te LPP-së. Kerkojm nga paneli shqyrtues qe lenden ta kthej ne rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.
Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.P.SH – "Prishtina Auto L.L.C"- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-se, si dhe shkelje të nenit 31 të RRUOPP dhe vendimit të OSHP-së nr.884/14 sepse

është anuluar aktiviteti i prokurimit edhe pse AK duhet të kërkojë me shkrim zgjatjen e validitetit të tenderit dhe atë duhet të kërkohet para datës së skadimit. AK nuk e ka respektuar këtë procedurë dhe si pasojë AK ka kërkuar nga OE Prishtina Auto LLC zgjatjen e validitetit të ofertë 18 ditë PAS datës së skadimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit nga AK është përcjellë me shumë mangësi dhe devijim nga afatet e përcaktuara në dosjen e tenderit lidhur me afatin e validitetit të ofertave dhe kërkesës së AK për zgjatjen e validitetit të ofertave. Më qëllim të sqarimit sa më të hollësishëm, në vijim do të elaborohet një përshkrim i kësaj procedure.

Sipas nenit 22 faqe 7 të dosjes se tenderit, periudha e vlefshmërisë së tenderit shkruan:

22. Periudha e Vlefshmërisë se Tenderit	22.1 Tenderët do të mbeten të vlefshme për aq kohë sa është e shënuar në FDT. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të filloj në datën e afatit të fundit te dorëzimit te tenderëve. Një tender që është valid për një kohë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues si jo e përgjegjshme. 22.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. Dështimi për t'iu përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.

Dorëzimi/hapja i tenderëve sipas platformës elektronike te KRPP-se është bere me datën 03.06.2020.

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderëve

Shfaq të gjitha funksionet e dokument

Versioni i tanishëm: 03.06.2020 12:58 177 Proces verbali i hapjes se Tenderve.pdf

Shqip

Ne dosjen e tenderit, respektivisht te FDT-ja neni 22.1 i saje, shkruan që vlefshmëria e tenderit është 60 ditë.

Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: 60 ditë,

Pra, nga hapja me date 03.06.2020 deri me datën 01.08.2020 oferta kanë pasur validitet. Sipas nenit 22.2 të dosjes së tenderit të dhënë më lartë "para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre". Sipas dispozitës së cekur më lartë, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave para skadimit të tyre por këtë e ka bërë me vonesë, respektivisht me datën 19.08.2020, d.m.th me 18 ditë vonesë. Me këtë rast, AK nuk ka respektuar nenin 22 të dosjes së tenderit dhe nenin 31.4 të RRUOPP. Arsyetimi i AK-së se vonesa e kërkesës për vazhdimin e validitetit është bërë për shkak të gjendjes pandemike sepse zyrtari përkatës i AK-së i ngarkuar me këtë aktivitet të prokurimit ka qenë i infektuar dhe në izolim nuk është argument që mund të justifikohet.

Gabimi tjetër në këtë proces i AK-së është se në kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës që ka bërë në platformën elektronike me datë 19.08.2020 në ora 12:40 ka theksuar për ofertuesit se: "ne presim përgjigje nga ana e juaj deri me datën 19.08.2020 ne ora 12".

Pra nga kjo shihet se është një anomali apo gabim teknik i AK në përcaktimin e datës për kthimin e përgjigjes nga operatorët ekonomik në të njëjtën datë me njoftimin e AK-së të paraqitur në sistemin e-prokurimi. Për këtë gabim të AK-së, nuk ka reaguar as OE ankues dhe nuk ka kërkuar sqarim prej AK-së se deri ne cilën datë mund të bëhet vazhdimi i validitetit të ofertës ose edhe të përgjigjet në kërkesën e AK-së, se pajtohet për vazhdim të validitetit të ofertës. Mos përgjigja e operatorit ekonomik në kërkesën e AK-së për vazhdim të validitetit të ofertës sipas nenit 22.2 të dosjes së tenderit të dhënë më lartë dhe nenit 31.6 të RRUOPP rezulton me refuzimin e tenderuesit si i pa përgjegjshëm. Mbi këtë bazë ka vepruar edhe autoriteti kontraktues me ofertën e OE ankues sepse ky i fundit nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e AK-së për vazhdimin e validitetit. Duhet theksuar se gjatë kësaj faze, respektivisht prej datës 28.07.2020 deri me datën 04.09.2020 lënda ka qenë e pezulluar dhe në shqyrtim të një ankese paraprake nga OSHP. Me datën 04.09.2020 OSHP nxjerrë vendimin nr.512/20 dhe kthen aktivitetin e prokurimit ne Rivlerësim.

Nga data 04.09.2020 e nxjerrjes se vendimit te OSHP-se nr.512/20 për rivlerësimin e këtij tenderi deri me datën 13.10.2020, respektivisht 15.10.2020 kur OE ankues ka kërkuar dy herë sqarime prej AK-së për ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, çështja ka mbetur e heshtur pa asnjë veprim nga AK. Me datën 03.11.2020 autoriteti kontraktues ka ngarkuar në platformën elektronike një raport të vlerësimit të ofertave i cili është mjaft i mangët dhe pjesërisht i plotësuar, pa ndonjë rekomandim të komisionit vlerësues. Me datën 10.11.2020 autoriteti kontraktues, përmes letrës standarde për eliminim njofton OE ankues se oferta e juaj është eliminuar për shkak se nuk jeni përgjigjur kërkesës për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit. Në të njëjtën datë jepet edhe Njoftimi mbi vendimin e AK-se për Anulim të aktivitetit të prokurimit për shkak se operatorët ekonomik nuk kanë vazhduar validitetin e ofertave. Marrë në përgjithësi, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.